



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që
veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.202300248/4

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Marrjen e masave për shqyrtimin e përfundimin sa më shpejtë të procedurës administrative të kërkesës/vetëdeklarimit të shtetasit V.B për legalizimin e ndërtimit informal të kryer prej tij.*

Marrjen e masave për evidentimin e personave që kanë sjellë si pasojë zvarritjen e procedurës administrative të shqyrtimit të vetëdeklarimit nr.1205, datë 06.11.2017, dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse ligjore ndaj tyre.

Marrjen e masave të nevojshme nga ASHK për evidentimin e shkaqeve të cilat kanë penguar dhe pengojnë mospërfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve të administruara në vite, si dhe adresimin e çështjeve për eliminimin e pengesave.

Drejtuar: Drejtorisë Vendore të ASHK-së

SARANDË

Për dijeni: Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
Adresa: Rruga "Dora D'Istria"

TIRANË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive apo interesave të ligjshme të individit, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasit V.B, në lidhje me zvarritjen e procedurave ligjore në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimit nr.1205, datë 06.11.2017, për legalizimin e ndërtimit informal të kryer prej tij.

Shtetasi V.B, me banim në ndërtimin informal të ndodhur në Qafë Gjashtë, Sarandë, ankohet ndaj Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, për shkeljen e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mospërfundimit të veprimtarisë administrative në shqyrtimin e kërkesës/vetëdeklarimit të tij, kryer në vitin 2017 për legalizimin e ndërtimit informal në posedim të tij.

Ankuesi shprehet se, në mënyrë të përsëritur ju është drejtuar për përfundimin e procedurave në shqyrtimin e kërkesës/vetëdeklarimit të tij për legalizimin e ndërtimit informal, dhe se, DVASHK-ja Sarandë, nuk është shprehur rreth arsyeve të cilat justifikojnë mospërfundimin e procedurës/veprimtarisë administrative për rastin e prezantuar prej tij.

Institucioni Avokatit të Popullit, për këtë çështje, bazuar në parashikimet e kryera në nenin 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe parashikimin e kryer në nenin 19, pika “b”, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, ka kërkuar DVASHK-së, Sarandë, me shkresën nr.K3/V3-2 Prot, datë 10.03.2023, informacion:

- Nëse DVASHK-ja Sarandë, ka të administruar vetëdeklarim për legalizim ndërtimi informal në emër të shtetasit V.B. Nëse po, cila është veprimtaria administrative e kryer deri më sot për shqyrtimin e tij?
- Cili është shkaku i mospërfundimit deri më sot i vetëdeklarimit për legalizim ndërtimi informal në emër të shtetasit V.B?
- Cilat janë mundësitë për përfundimin sa më parë të shqyrtimit të vetëdeklarimit të kryer prej V.B?
- Çdo informacion tjetër që lidhet me këtë çështje.

Në përgjigje të kërkesës, DVASHK Sarandë, me shkresën nr.3842/1 prot, datë 05.04.2023, drejtuar Avokatit të Popullit, shprehet midis të tjerave, se:

“Nga verifikimet pranë Sektorit të Legalizimeve Çështjeve të Pronësisë dhe Proçeseve Hartografike, rezulton aplikimi me nr.1205, datë 06.11.2017, në emër të subjektit aplikues V.B, objekt i ndodhur në Gjashtë, Bashkia Sarandë, dosje e cila rezulton ende në fazë fillestare, e pa marrë në shqyrtim, për t’u trahtuar nga ana e DVASHK-së Sarandë. Në momentin që praktika e mësipërme do të merret në shqyrtim, DVASHK Sarandë, do të njoftojë subjektin V.B”.

➤ **Arsyetimi ligjor i fakteve dhe rrethanave**

Sikundër kuptohet, për shqyrtimin e kërkesës/vetëdeklarimit për legalizim të ndërtimit informal të ankuesit, nuk është zhvilluar asnjë procedurë apo veprimtari administrative, situatë e cila, referuar përgjigjes së dhënë, nuk justifikohet se për çfarë shkaqes ka ndodhur dhe ndodh.

Institucioni ynë, gjatë procesit të hetimit administrativ ka konstatuar shkelje të procesit të rregullt ligjor në shqyrtimin e kërkesës për legalizim të objektit informal, duke e zvarritur këtë proces tej çdo afati të arsyeshëm ligjor. Konkretisht, nga dokumentacioni i depozituar

nga ankuesit rezulton se është aplikuar për legalizimin e objektit informal rreth 6 vite më parë dhe akoma nuk është marrë një vendim përfundimtar për këtë rast.

Gjatë veprimtarisë së DVASHK-së Sarandë, në lidhje me këtë çështje, konstatohet se është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor. Një nga mënyrat e cënimit të kësaj të drejte është edhe mospërfundimi i procesit administrativ, të shqyrtimit të vetëdeklarimit në afatin ligjor të parashikuar apo në një afat të arsyeshëm ligjor, parashikuar në nenin 91 të “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, se:

“Afati për përfundimin e procedurës administrative

- 1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.*
- 2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.*
- 3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre.*
- 4. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, procedura administrative përfundon brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.*
- 5. Mosrespektimi i afateve kohore, të parashikuara në këtë nen, duhet të justifikohet nga organi përgjegjës para organit epror ose nga nëpunësi përgjegjës përpara eprorit të tij, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit ose nga përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme”.*

Bazuar në parashikimet e ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ish-ALUIZNI, sot ASHK-ja, është organi i cili shqyrton kërkesat për legalizim të objekteve informale.

Neni 4 i këtij ligji, në pikën 2 të tij, ka parashikuar në mënyrë eksplicite detyrat funksionale të këtij institucioni:

“Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) është institucioni përgjegjës për: a) bashkëpunimin dhe njësimin e procedurave me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për procesin e legalizimit, urbanizimit dhe të integritit të zonave/vendbanimeve/bllokbanimeve me ndërtime të legalizuara; b) programimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit për legalizimin dhe urbanizimin e territoreve informale; c) dhënien e lejes së legalizimit, sipas nenit 28 të këtij ligji”.

Neni 10 i këtij ligji parashikonte kompetencat e plota dhe detyrimin e ish-ALUIZNI-t për zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithëanshëm administrativ, brenda afateve ligjore të përcaktuara:

“Në rast se pas kalimit të afateve, zyrat e urbanistikës apo këshillat e qarqeve, nuk ushtrojnë përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen, atëherë ALUIZNI merr përsipër ushtrimin e tyre. Afatet, mënyra dhe koha e ushtrimit të këtyre përgjegjësive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 33 i ligjit parashikonte:

“Mosplotësimi nga subjekti i dokumentacionit përkatës, sipas përcaktimeve të këtij ligji, sjell përjashtimin nga procesi i legalizimit, urbanizimit dhe integritimit të ndërtimeve informale”.

Neni 38/1 parashikonte:

“Ndërtimet pa leje, të ngritura brenda kufirit të vijës turistike, u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë ligj, sipas kritereve të përcaktuara në instrumentet e planifikimit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit”.

Pra, në mënyrë të qartë, ligji parashikonte zhvillimin e procedurave administrative edhe në këtë rast dhe vetëm në përfundim të hetimit administrativ, me vendim të arsyetuar vendoset mbi shkakun e kualifikimit apo jo të objektit. Ndërsa, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni i zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

VKM-ja nr.589/2014, *“Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”*, në pikën 5, sek II të saj, rikonfirmon detyrimin e drejtorive rajonale për zhvillimin e hetimit administrativ dhe më pas arritjen në përfundim për marrjen e vendimit përkatës:

“Drejtoritë në varësi të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) duhet të kryejnë procedurat e evidentimit në terren, të përgatitin dokumentacionin e gjendjes faktike të ndërtimeve informale, si dhe të hartojnë dokumentacionin teknik e ligjor për zonën informale”.

Neni 28 i ligjit nr.9482/2006, parashikonte:

“Zyra përkatëse e ALUIZNI-t, me plotësimin e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në nenin 27 të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga përfundimi i procedurave administrative, pajis subjektin me lejen e legalizimit. I njëjti rregullim, por me ndryshime specifike, të përcaktuara në këtë ligj, zbatohet edhe për "shtesat pa leje në ndërtime me leje". Kriteret, procedurat dhe formulari i lejes së legalizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Formulari i vetëdeklarimit i bashkëlidhet këtij ligji, si shtojca "A" e ligjit”.

Pra, pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, ligji parashikonte një afat prej 30 ditësh për vënien në dispozicion të lejes së legalizimit, aplikuesit. Zvarritja e procesit prej afro 6 vitesh nuk gjen asnjë justifikim ligjor apo llogjik dhe mbi të gjitha çënon sigurinë juridike në një shtet demokratik.

Gjithashtu, qëndrimi i kësaj drejtorie vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 50 të ligjit 111/2018 *“Për Kadastrën”*, si dhe **nenin 21** të ligjit 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, ku parashikohet:

“ASHK-ja, brenda 60 ditëve nga përfundimi i procedurave të kualifikimit, legalizon ndërtimin, duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për regjimet pasurore martesore”.

Pra ky ligj parashikonte një afat prej 60 ditësh nga përfundimi i procedurave të kualifikimit për pajisje me leje legalizimi. Ndërsa lidhur me nxjerrjen e vendimit për skualifikimin e objektit nga procesi i legalizimit, nuk parashikohet një afat ligjor. Gjithashtu ky ligj nuk përcakton një afat për përfundimin e shqyrtimit administrativ të aplikimeve për pajisje me leje legalizimi.

Ndodhur në kushtet kur ligji posaçëm nuk parashikon afate për përfundimin e procesit administrativ, do t'i referohemi dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Kodi i Procedurave Administrative, **në nenin 53 të tij**, parashikon:

“Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”,

si dhe nenit 91, si më sipër cituar.

Pra, asnjë organ administrativ/institucion shtetëror nuk mund të fillojë një procedurë administrative dhe ta zvarrisë atë pafundësisht, por duhet ta përfundojë atë brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

Afatet ligjore fillojnë në ditën e paraqitjes së kërkesës apo ankesës në një organ të administratës publike dhe përfundojnë në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar administrativ. Qëllimi i vendosjes së afateve ligjore dhe respektimi i tyre është përfundimi sa më shpejt i procedurës administrative dhe brenda një kohe të arsyeshme, në respektim të procesit të rregullt ligjor.

Respektimi i afateve gjatë procesit administrativ përbën bazën e sigurtë të çdo rendi juridik ligjor e demokratik pasi:

- procesi administrativ përbën hallkën e parë dhe më të prekshme të procesit ligjor, përmes të cilit qytetari në përpjekje për të fituar apo mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij përballat me administratën shtetërore dhe vendore.

- procesi administrativ tregon qartë cilësinë e aksesit në drejtësi, pasi gjatë këtij procesi cdo shtetas kupton dhe percepton më qartë mënyrën se si jepet drejtësia. Mungesa e afateve të arsyeshme në përfundimin e procesit administrativ e bën të paplotë këtë angazhim, duke cënuar drejtpërdrejt të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

- procesi administrativ duke cënuar procesin e rregullt ligjor, ka mohuar garancin për çdo shtetas ndaj veprimeve të paligjshme e të parregullta të organeve të administratës

publike, si dhe detyrim për këto të fundit që të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, gjatë veprimtarisë së tyre administrative.

-detyrimi për një proces të rregullt ligjor buron edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut neni 6 i saj, i cili kërkon detyrimisht aplikim rigoroz nga instrumentat e brendshëm të një shteti.

-Në respekt të këtij parashikimi, e drejta për një proces të rregullt ligjor është ngritur në nivel Kushtetues, konkretisht, neni 42/1 i cili citon se : “Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe ligj, nuk mund të çënohen pa një proces të rregullt ligjor”.

Referuar rastit në hetim, nuk rezulton që DVASHK-ja Sarandë, si një organ administrativ të ketë zbatuar këto detyrime ligjore në kuadër të sigurimit të një procesi të rregullt ligjor. Hetimi administrativ ka treguar se *jo vetëm konstatohet tejkalimi i afateve, por vlerësohet i drejtë shqetësimi i ngritur nga ankuesi, për shkeljen e afateve ligjore, në rastin e trajtimit të kërkesës së ankuesit.*

Konkretisht, rezulton se ka vonesa në komunikimin ndërmjet DVASHK-së Sarandë me ankuesin. Kështu, siç shpjeguar DVASHK-ja Sarandë, nuk i jep zgjidhje ankesës konkrete por në të kundërtën informohemi se kjo çështje lihet të trajtohet në një afat të pacaktuar, pasi nuk ka filluar fare trajtimin e kërkesës së bërë nga ana e ankuesit prej më shumë se 6 vitesh.

Theksojmë se për sa kohë nuk ka akte normative, që të përcaktojnë afate të tjera për institucionin tuaj gjatë trajtimit të kërkesave të shtetasve, të vetmet afate ligjore që duhen zbatuar me përpikëri, janë ato të referuar më sipër.

Sjellim në vëmendjen Tuaj se Institucioni ynë përpiqet të mirëkuptojë volumin e madh të rasteve që ka në trajtim Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe vlerëson punën që bëhet nga specialistët e këtij institucioni, por nga ana tjetër duke patur parasysh rëndësinë e zgjidhjes së problemeve të pronësisë (jo vetëm procesin e legalizimeve, por edhe atë të kthimit dhe kompensimit të pronave), si në raport me zhvillimin ekonomik të vendit, ashtu edhe të garantimit të të drejtës së pronësisë së shtetasve, ka rekomanduar edhe më parë ndërmarrjen e veprimeve konkrete, për shpejtimin e zgjidhjes së këtyre çështjeve.

Gjithashtu, referuar informacionit të dhënë nga ana juaj në shkresën nr.3842/1 Prot, datë 05.04.2023, në përgjigje Tonës nr.K3/V3-2 Prot, datë 05.04.2023, konstatojmë se jo vetëm që nuk mbështetet ky qëndrim ligjërisht, por ka edhe disa parregullsi e problematika të tjera, si vijon:

- a. Nisur nga informacioni që jepet, kur thuhet, se: “...Në momentin që praktika e mësipërme do të merret në shqyrtim, DVASHK Sarandë, do të njoftojë subjektin V.B ...”, sjellim në vëmendjen Tuaj se kjo çështje ka qenë dhe është në shqyrtim prej ditës së administrimit të kërkesës/vetëdeklarimit nr.1205, datë 06.11.2017, të ankuesit

Në këto rrethana, nisur dhe nga komunikimi disavjeçar i vazhdueshëm, për çështjet e legalizimeve, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk është vënë në dijeni nëse për evitimin e kësaj problematike ka ndonjë propozim, apo marrjen e ndonjë mase konkrete si nga drejtorit vendore, ashtu edhe nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i saj).

Problematika e trajtuar në këto raste jo vetëm që prek të drejtat e shtetasve për të trajtuar çështjet e tyre brenda afateve të parashikuara nga aktet normative në fuqi, në mënyrë të ligjshme, transparente, të paanshme, të drejtë, por prek edhe të drejtën e tyre për tu informuar për veprimtarinë e organeve shtetërore.

Këto janë të drejta të parashikuara jo vetëm nga Kodi i Procedurave Administrative (nenet 4, 5, 6, 10, 13, 15, 18/2, etj), por së pari nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në **nenin 23**, pika 2, sanksionon se:

“2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, ...”,

Neni 42, pika 1, e Kushtetutës, sanksionon se:

“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”.

Neni 15, pika 2, e Kushtetutës, sanksionon se:

“ organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre ”.

Në analizë të parashikimeve Kushtetuese rezulton se ankuesi, për shkaqe të pavarura nga ai, nuk arrin të marrë një vendim përfundimtar në një procedurë administrative, në një kohë që ka respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, e për rrjedhojë ai nuk e gëzon pronën e tij, të drejtat që i garanton legjislacioni në fuqi. Institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin e praktikës së shtetasit V.B, kufizon liritë dhe të drejtat e tij të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, e më konkretisht, të drejtën e pronësisë.

Një tjetër çështje që sjellim në vëmendjen Tuaj për shkak të zgjatjes së procedurës administrative pa përcaktuar një afat fundor **është cënimi i parimit të sigurisë juridike**.

Siguria juridike parakupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Organet e administratës nuk mund të përkeqësojnë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojnë të drejtat e fituara ose të shpërfillin interesat legjitime të tyre.

Besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm jo vetëm për t'u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese por edhe nga veprimtaria e administratës gjatë veprimtarisë së saj.

Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet pandryshueshmëria e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe të garantojë ligjshmërinë e veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasin një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarit tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së organeve të administratës me padi civile për dëm jashtëkontrator, që mund t'i jetë shkaktuar shtetasit, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.

Sa më sipër parashtruar, vlerësojmë se qëndrimi i mbajtur nga DVASHK-ja Sarandë, në vlerësim të Institucionit të Avokatit të Popullit tregon neglizhencën administrative të institucionit publik, të cilët në mospërmbushje të plotë të detyrave të tyre dhe pa asnjë shkak teknik apo ligjor të dokumentacionit referues nuk ka marrë masat për trajtimin e kërkesës së ankuesit..

Ligji dhe aktet ligjore në funksion të legalizimit të objekteve informale parashikojnë afate ligjore për zhvillimin e procesit të legalizimit, pasi një proces administrativ nuk mund të vazhdojë pafundësisht.

Organet e administratës publike duhet të bëjnë përpjektjet maksimale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor e në përputhje me nenit 6/1 të KEDNJ. Kjo procedurë, nuk është filluar fare nga ana e ish-Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t dhe sot DVASHK-ja Sarandë, pa asnjë shkak të justifikuar ligjërisht edhe pse është kërkuar vazhdimisht përfundimi i saj.

Në këto kushte, ky institucion gjendet në shkelje të procesit të rregullt ligjor, në zhvillimin e procesit administrativ. Për gjithë sa parashtruar, vlerësojmë se Institucioni juaj duhet të përmbush detyrimet ligjore në lidhje me procedurat, duke shmangur vonesat e panevojshme të shkaktuara nga inercia, neglizhenca apo zvarritja e qëllimshme e procesit.

Sjellim në vëmendjen Tuaj se në lidhje me përgjegjësinë e administratës publike dhe keqadministrimin e veprimtarisë së tyre është shprehur edhe parlamenti European, sipas të cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”.

Referuar analizës së fakteve në lidhje me referencat ligjore , në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 21/b të Nr.8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr.155/2014, datë 27.11, që përcaktojnë se:

“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për shqyrtimin e përfundimin sa më shpejtë të procedurës administrative të kërkesës/vetëdeklarimit të shtetasit V.B për legalizimin e ndërtimit informal të kryer prej tij.

Marrjen e masave për evidentimin e personave që kanë sjellë si pasojë zvarritjen e procedurës administrative të shqyrtimit të vetëdeklarimit nr.1205, datë 06.11.2017, dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse ligjore ndaj tyre.

Marrjen e masave të nevojshme nga ASHK për evidentimin e shkaqeve të cilat kanë penguar dhe pengojnë mospërfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve të administruara në vite, si dhe adresimin e çështjeve për eliminimin e pengesave.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Me besim në bashkëpunimin tuaj!

Në mungesë dhe me Urdhër

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI